REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 948/20
Datë/Datum. 20.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Lulzim Bajrami **Ekspert Shqyrtues**	**Data e autorizimit të ekspertit** **18.11.2020**	**Data e dorëzimit të raportit** **20.11.2020**

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën 20.10.2020, grupi i operatorve ekonomik **"EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I –Suharekë"** ka parashtruar ankesë me **nr: 948/20.** kundër njotimit mbi vendimin e AK ku është rekomanduar për kontratë operatorit ekonomik **""NBT -ING" SH.P.K"** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve- Faza e Tretë- Përfundimtare"** me nr. të prokurimit **624-20-5546-5-2-1.** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK). **Komuna e Suharekës.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur. lloji i kontratës: furnizim. vlera e parashikuar e kontratës është **170.000,00 €.**

- Data e njoftimit për kontratë **23.09.2020**
- Data e hapjes së ofertës **05.10.2020**
- Data e (njoftimi për dhanie te kontrates) - njoftimit mbi vendimin e AK: **30.10.2020**
- Data e njoftimit të ofertuesve: **30.10.2020**

Konform nenit 113. 114 të Ligjit Nr. 04/L-042. i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237. Ligjin 05/ L-068. dhe Ligjin 05/ L-092. Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Grupi i operatorve ekonomik **"EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë"** ne ankesën e parashtruar ne pretendimet ankimore ka si ne vijim:

OPERATORI ANKUES PRETENDON SE: AK ka vepruar ne kundershtim me kriteret e vendosura ne Dosjen e tenderit me rastin e eliminimit te ofertes se tyre.

Raporti i ekspertit shqyrtues. lidhur me ankesën e parashtruar nga **Grupi i OE "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë".** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve- Faza e Tretë- Përfundimtare"** me numer te prokurimit **624-20-5546-5-2-1** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK). **Komuna e Suharekës.**

Përmes plateformes elektronike te KRPP-se njoftohemi mbi Vendimin e Auortetit Kontraktues me dt. 30.10.2020, se per aktivitetin e prokurimit me titullin "**Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve- Faza e Tretë- Përfundimtare**" me numer te prokurimit **624-20-5546-5-2-1** është shpallur fitues operatori ekonomik **„NBT – ING SHPK"**

Te pakenaqur me kete vendim, ne baze te dispozitave te LPP-se kemi bere kerkes per qasje ne dokumentacionin e tenderit fitues me dt.30.10.2020 dhe po ne te njejten dite dt.30.10.2020 ne ora 15:00 na eshte ofruar qasja ne dokumentacionin e tenderit me qerast konstatojm se:

Gajte vleresimit te tenderit Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP respektivisht Nenin 1, Nenin 7, Nenin 56, Nenin 59, Nenin 60, Nenin 66 dhe Nenin 72 duke shpallur fitues Operatorin ekonomik **NBT – ING SHPK** duke mos respektuar dispozitat e LPP kryesisht kriteret e FTD pika 30.1 **Tenderi çmimi me i ulët.**

Prova Materiale 1.

Ne letren standarde per tenderuesin e pasuksesshem dt.30.10.2020 thuhet: **Tenderi juaj është refuzuar per kete arsye: -** I pakompletuar. ING e Arkitektures - Arzije Zeneli nuk ka referenca qe ka punuar ne Ministrin e kultures rinis dhe sporti sipas CV-së.

ING e Hidroteknikes – Zarife Sallahu, kontrata e punes e lidhur me dt.13.03.2018 nuk korrespodon me CV-in e leshuar pasi qe ne CV eshte data qe ka fillua punen 0103.2016.

Ju njoftojm se ne Kriteret e FTD-se, nuk eshte kerkuar fare referenca per inxhinier, shih poshte kerkesat e FTD-së:

Kërkesa 2 - OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierve të kyçur ne project
-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë (ose master ne ndertimtari) drejtimi konstruktiv, minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.
- Një (1) Inxhinier i Dip. i Arkitektures (ose master ne arkitekture) minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.
-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik (ose master ne hidroteknik) minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.
-Një (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (ose bachelor) me licence, minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.
-Një (1) Inxhinier i dip.i Elektros (ose master) – minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia 2 - Kontrata e punës ose mareveshjet me inxhinierit, Diploma (dhe licensa per gjeodetin) e NOTERIZUAR dhe nga një CV.

Edhe pse nuk eshte kerkuar referenca AK eshte dashur siq keni vepruar ne nje rast tjeter te kerkoni sqarime dhe te na mundesoni te plotesojm dokumentacionin (Referencen e pa kerkuar ne FTD), megjithate ne kemi bere kerkes tek Arkitektja e cila me kerkes zyrtare eshte pasiur me reference nga Instituti i Kosoves per Mbrojtje te Menomenteve, pran MKRS nr.01-R/2020 dt.28.10.2020 me numer te protokollit 300 dt.28.10.2020.

Ne dokumentacionin e tenderit ne kemi dorzuar Kontraten, Refeencen nga Kompani jone, listen e ATK-s ku deshmohet se puntorja eshte ne marrdhenie pune me kompanin tone, dhe ne e kemi plotesuar kete kriter edhe ps reference, mirepo per nderin tuaj po ju bashkangjiesim edhe referencen e lartepermendur leshuar nga Instituti i Kosoves per Mbrojtjen e Momumenteve, pran MKRS-s.

Sa i perket inxhinjeres se Hidrotekniker Zarife Sallhu, ku thuhet se ING e Hidroteknikes- Zarife Sallahu kontrata e punes e lidhur me dt.13.03.2018 nuk korrespodon me CV-n, e leshuar pasi qe CV eshte data qe la filluar punen 01.03.2016 ju njoftojm se Zarife Sallahu eshte punetore-inxhinjere e hidros ne kompanin tone nga 01.03.2016 vazhdon akoma me te cilen ju deshmojm me Lista e ATK-s per kete periudh kohore dhe ka kontrat pune valide deri me 31.12.2020 ju kujtojm se kontratat vazhdohen ne periudha te caktuara sipas marrveshjes.

Bashkangjitur gjeni listat e ATK-s 2016,2017,2018,2019,2020.

Prandaj pas sqarimeve qe po ju dergojm kerkojm nga ju qe gjate rivleresimit te na shpermbleni me kontrate sepse ne kemi dorzuar oferten me te ulet dhe te pergjegjeshme.

Siq keni vleresuar edhe ju, ne Njoftimin mvi vendimin e AK kompanit si me poshte jane te pa pergjegjeshme:

NNP AS-ING eshte i pa pergjegjeshme per arsyeje se: mungon sigurimi i tenderit, diplomat e noterizuara per inxhinjere mungojn EN-ISO 9001:2015, EN-ISO 14001:2015 Certificate of conformity (cilesia e gurit)

AAB CONSTRUCTION SHPK eshte i pa pergjegjeshme per arsyeje se: mungon sigurimi i tenderit mungojn te gjitha ingjinjeret po ashtu edhe qertifikatat ISO standardet.

GEO Limit L&B sh.p.k; EuroVia SHPK eshte i pa pergjegjeshem per arsyej se: i pakompletuar ING i Hidroteknikes nuk ka fare referenca per pune sipas CV se prezantuar po ashtu edhe noterizimi i diplomes nuk perputhet me te dhenat e personit ne fjale.Eshte kerkuar qe stafi teknik te ket 10 punetor ndersa operatori ekonomik ka prezantuar 9 kontrata te te punesuarve dhe kontratat e punes per Milaim Zyrapi nuk eshte e nenshkruar.

Te pasijet per kryerjen epunimeve ne njoftimin e kontrates eshte kekruar 2 kamion te rende, ndersa OE ka prezantuar 1 kamion te rend.

N.P.T. Bamires", eshte i pa pergjegjeshem per arsyej se: i pakompletuar, mungon sigurimi i tenderit mungon qertifikata e konformitietit te cilesis.

Visar Kuçi B.I eshte i pa pergjegjeshem per arsyeje se : i pakompletuar mungon sigurimi i tenderit, mungojn inxhinjerat per kryerjen e ketij projekti, po ashtu mungojn qertifikata e konformitetit per cilesin e gurit.

Prandaj duke shikuar te gjitha dokumentacionin e tenderit ofertat e dorzuara nga operatoret ekonomik kerkojm nga ju qe te beni rishqyrtimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates 30.10.2020 dhe NE te shpallemi fitues si Tenderi i pergjegjeshem me çmimin me te ulet.

Dispozitat e shkelura nga ana e AK sipas OE ankues janë:

- Neni 1 i LPP, Neni 7 i LPP; Neni 56 i LPP; Neni 59 i LPP; Neni 60 i LPP;Neni 66 i LPP; Neni 72 i LPP; dhe Neni 108/A i LPP;

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

N/A

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni pasi vleresoi ofertat elektronike i rekomandon ZP-se qe te shpalle fitues OE NBT -ING me qmim me te lire ne vlere prej 167,823.50 euro

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit ne detaje te procedurës se tenderit si dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore te OE dhe dokumentacioni ne dispozicin te kësaj procedure te prokurimit eksperti shqyrtues jep këtë mendim:

Përgjegjien ne pretendimet ankimor për Inxhinier te ARKITEKTURËS dhe Inxhinier te HIDROTEKNIKES:

Autoriteti kontraktues ne njoftimin për kontratë te datës 23.09.2020 dhe Dosjes se Tenderit tek përcaktimi i kritereve kerkesat dhe dëshmit i ka vendosur si ne vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 2 - OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhiniereve të kyçur ne project** **-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë (ose master ne ndertimtari) drejtimi konstruktiv, minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.** **- Një (1) Inxhinier i Dip. i Arkitektures (ose master ne arkitekture) minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.** **-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik (ose master ne hidroteknik) minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.** **-Një (1) Inxhinier i diplomuar i**	**Dëshmia e kërkuar dokumentare** **Dëshmia 2 - Kontrata e punës ose mareveshjet me inxhinierit, Diploma (dhe licensa per gjeodetin) e NOTERIZUAR dhe nga një CV.**

		gjeodezisë (ose bachelor) me licence, minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit. **-Një (1) Inxhinier i dip.i Elektros (ose master) – minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.**	

Autoriteti Kontraktues me rastin e eliminimit te grupit te operatorëve ekonomik **"EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë"** ka vepruar ne kundershtim me Kritereve te vendosura ne Dosjen e tenderit tek **Kërkesat mbimundësitë teknike dhe/ose profesionale. LPP Nenin 59, 72 dhe RROUP-në pikë 39 dhe 39.8.**

1. Grupit te operatorëve ekonomik **"EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë"** ne ofertën e tyre kan prezantuar. Inxhinierin e Arkitekturës konform kerkesave te dosjes se tenderit ku kan prezantuar Diplom Universitare për inxhinier te Arkitektures. Arzije Zeneli te përfunduar me dt.10.11.2004 : nr.276 ne Universitetin e Prishtinës. Kontratën e punës me nr.**K.P.1/19 te dt.01.02.2019** dhe CV-në.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues me rastin e eliminimit te operatoreve ekonomik ne kete pikë te vendosur ne letren standarde eliminuese kanë cekur se: ***„ING e Arkitekturës, Arzije Zeneli nuk ka referenca qe ka punuar ne Ministrin e kultures rinis dhe sportit sipas CV"*** ky arsyetim i AK nuk qëndron pasi që ne dosjen e tenderit nuk ka kerkuar fare **Referencë** andaj eliminimi i operatorit ekonomik nga ana e AK ne kete pikë është i pa arsyeshem dhe i pa bazuar dhe ne kundershtim me vendosjen e kritereve te dosjes se tenderi. dhe pretendimi ankimor ne kete pikë i operatorit ekonomk është **i bazuar.**

2. Grupit te operatorëve ekonomik **"EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë"** ne ofertën e tyre kan prezantuar. Inxhinierin e Hitroteknikës konform kerkesave te dosjes se tenderit ku kan prezantuar Diplom Universitare për inxhinier te Hidroteknik Zarife Sallhu te përfunduar me dt.23.06.2006 nr.439 në Universitetin e Prishtinës. Kontratën e punës me nr.**K.P.5/18 te dt.13.03.2018** dhe CV-në.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues me rastin e eliminimit te operatoreve ekonomik ne kete pikë të vendosur ne letren standarde eliminuese kanë cekur se: ***„ING e Hidroteknikës, Zarife Sallhu, kontrata e punës e lidhur me dt.13.03.2018 nuk korrespodon me CV e lëshuar pasi që CV është data qe ka filluar punen me 01.03.2016"*** nuk është i arsyeshëm pasi që ne këto raste autoritetet kontraktuese është dashur qe te kërkojn sqarime shtesë ne bazë **LPP Nenit 72** dhe **RROUP pikës 39 dhe pikës 39.8** dhe te konstatoj drejt dhe sakt vleresimin e ofertës.

Pika 39.8 e RROUP , Tabela njoftuese ne rastet e kerkimit te sqarimeve.

CV-ja e dorëzuar nuk përmbanë informatat e kërkuara. AK nuk mundet te vendos.	Mund te kërkohën informata sqaruese	Neni 69

Andaj operatori ekonomik ankues ka dorzuar **CV dhe Kontratat** dhe për çdo pa qartësi AK është dashur qe te kërkoj sqarime nga ana e OE dhe te vleresoj drejt pretendimin dhe arsyetimin e eliminimit te operatorit ekonomik lidhur me kete pikë. dhe pretendimi ankimor ne kete pikë i operatorit ekonomk është **i bazuar.**

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke pasur parasysh sqarimet e lartëcekura dhe bazuar ne zhvillimin e procedurës se prokurimit dhe dokumentacionit te ofertave dhe vleresimit, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohët **si e bazuar.** të anulohet njoftimi për dhanie te kontratës dhe procedura te kthehët ne **Ri-vlersim.**

Autoriteti kontraktues duhet te ketë parasysh zbatimin e Neneve 1, 6, 7, 59, 72 të LPP-së, RROUP pikën 39 dhe 39.8 si dhe Kriteret e Vendosura ne Dosjen e Tenderit, dhe Nenin 60 te LPP-së me rastin e rivleresimit te aktivitetit te prokurimit.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna e Suharekës.
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues - "Eko Term" SH.P.K & N.N.SH "Top Projekt"& "Lirim Bujari" B.I"